



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2022

VENDIM

Nr. 417, datë 13.10.2022

PËR

CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LEZHË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Alda Sadiku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen penale me të pandehur: {...} dhe {...}; Akuza: Nenet 76 dhe 278/1 e 274, 84, 302 të Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PUKË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Besmir Stroka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Kërkues: {...}; Person i tretë: {...}; Objekti: Heqje e zotësisë për të vepruar për shtetasen {...} dhe caktimin si kujdestarë të bashkëshortit të saj shtetasit {...}

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Arta Llazari, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Person i tretë: {...}; Objekti: Shpallje e vdekjes së shtetasit {...}.

3. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Arta Llazari dhe Besmir Stroka, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë,

çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr.65, viti 2021; I pandehur {...}; Akuza: Vrasje e mbetur në tentativë e parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TROPOJË

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, Suada Kurti dhe Florin Demollari, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, çështjen penale me Kërkues: {...}; Objekti: Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. 156 të vitit 2021; I pandehur: {...}; Akuza: “Vrasje me dashje” dhe “Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit” të parashikuara nga nenet 76 dhe 278/1 të Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PËRMET

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, Dejvi Çelçima, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet; I pandehur: {...}; Akuza: “Drejtimi i automjeteve në gjendje të dehur” të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal; Objekti: Dërgimi i çështjes në gjyq.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LUSHNJË

1. Gjyqtaret e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Sonila Hoxha dhe Erlanda Agaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}, {...} dhe {...}; Akuza: “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” e kryer kundër dy ose më shumë personave, konsumuar ndaj viktimës {...} dhe mbetur në tentative ndaj viktimës {...}; “Plagosje e lehtë me dashje” (ndaj viktimës {...}); Prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve të gjahut dhe sportive” parashikuar nga nenet 79/dh e 22, 89, 280 i Kodit Penal, etj.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË KORÇË

1. Gjyqtarja e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Nafije Hasko (Curri), caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, çështjen administrative me Paditës: {...} sh.p.k; I Paditur: {...}; Objekti: Detyrimin e palës së paditur për përmbushjen e detyrimeve kontraktore që rrjedhin nga punime të kryera nga shoqëria dhe pagimin e detyrimit. Marrjen e masës së sigurimit të padisë. Zgjidhje kontrate.

2. Gjyqtarja e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Nafije Hasko (Curri), caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, çështjen administrative me Paditës: Bashkia Pogradec; I paditur: {...}; Objekti: Shpërblimin e dëmit të shkaktuar si rrjedhojë e situacionit të punimeve të pakryera, sipas volumeve të stacionuara, etj. Baza ligjore: neni 31, 32/a, 154 I K.Pr.Civile, neni 608 e vijues i K.Civil, Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, Ornela Naqellari (relatore), Edlira Petri dhe Lutfije Celami, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Mashtrimi.

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Korçë, Dritan Hasani dhe Arta Duka, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Falsifikimi i dokumenteve.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Korçë, Arta Duka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Vrasje me dashje.

4. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Korçë, Dritan Hasani dhe Arta Duka, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}; Akuza: Ndhimë për kalim të paligjshëm të kufirit.

GJYKATA E APELIT VLORË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Arben Dosti, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}; Objekti: “Shuarje e masës së sigurimit” gjatë gjykimit të themelit të çështjes. Gjyqtari i përzgjedhur për këtë çështje {...}, do të jetë edhe anëtar i trupit gjykues në gjykimin e themelit të çështjes penale me të pandehur Romeo Oçe.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR